

SA JANË TRANSPARENTE DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS?

PËRMBAJTJA

TRANSPARENCA DHE QASJE NË INFORMACION

SFIDAT E TRANSPARENCËS

GJETJET E FDHK

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DSHK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) kanë juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të cilat ndërlidhen me pengimin e administrimit të drejtësisë, e që janë të ndërlidhura me pretendimet e paraqitura në Raportin¹ e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të datës 7 janar 2011.

DHSK janë në qendër të diskutimeve dhe shqetësimeve lidhur me transparencën dhe integritetin e këtij institucioni.

Ky buletin ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi përpjekjet dhe sfidat që lidhen me transparencën e këtij institucioni.

Që nga themelimi i DHSK&ZPS, janë ngritur tre aktakuza për krimet e luftës kundër gjashtë (6) personave të akuzuar: Prokurori kundër Salih Mustafës,² Prokurori kundër Pjetër Shalës,³ dhe Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve.⁴



TRANSPARENCA DHE QASJE NË INFORMACION

Transparenca dhe qasje në informacion

-DHSK është angazhuar të publikojë vendimet, procesverbalet dhe dokumente të tjera të rëndësishme për të siguruar qasje të hapur për publikun. Megjithatë, për shkak të natyrës së ndjeshme të rasteve, disa seanca dhe dokumente janë të mbyllura për publikun për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe të dhënat sensitive.

-Për të siguruar një komunikim, DHSK ka një zyrë për marrëdhëniet me publikun e cila ofron informacione dhe përgjigje në pyetjet e qytetarëve dhe mediave. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit dhe ruajtjen e transparencës.

-Gjykimet mund të monitorohen fizikisht apo përmes transmetimit online në faqen zyrtare të DHSK, në tre gjuhë, në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

Sfidat e transparencës

-Një pjesë e konsiderueshme e seancave janë të mbyllura për publikun për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe për të siguruar sigurinë e tyre. Ky fakt ka ngritur shqetësimet në lidhje me nivelin e transparencës dhe qasjen e publikut në proceset gjyqësore.

Në rastin Prokurori kundër Salih Mustafës nga katërbëdhjetë (14) dëshmitarë të dëgjuar të prokurorisë, dhjetë (10) prej tyre janë dëgjuar me masat e sigurisë, duke i identifikuar si dëshmitarë me shifra pa e publikuar identitetin e tyre për publikun dhe kryesisht dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë dhënë në seancat e mbyllura.

¹ https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/coe_0.pdf

² Salih Mustafa është dënuar me vendim të plotfuqishëm për krime lufte me 22 vite burgim.

³ Pjetër Shala është dënuar nga shkalla e parë me 18 vite burgim për krime lufte, palët kanë të drejt ankese në Gjykatën e Apelit.

⁴ Në rastin Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, procedura gjyqësore është në fazën e shqyrtimit kryesor dhe janë duke u dëgjuar dëshmitarë të propozuar nga prokuroria.

Në rastin Prokurori kundër Pjetër Shalës nga dhjetë (10) dëshmitarë të dëgjuar të prokurorisë, shtatë (7) dëshmitarë prej tyre janë dëgjuar me masat e sigurisë, duke i identifikuar si dëshmitarë me shifra pa e publikuar identitetin e tyre për publikun dhe pjesërisht dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë dhënë në seancat e mbyllura.

Në rastin Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve nga dëgjimi i tetëdhjetë e dy (82) dëshmitarëve të propozuar nga ZPS, prej fillimit të shqyrtimit kryesor deri në gusht të vitit 2024, rreth pesëdhjetë (50) dëshmitarë janë dëgjuar me masat e sigurisë duke i identifikuar si dëshmitarë me shifra pa e publikuar identitetin e tyre për publikun dhe kryesisht dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë dhënë në seancat e mbyllura.

-Një numër i konsiderueshëm i dokumentacionit i cili është i qasshëm në faqen zyrtare të këtij institucioni gjyqësor nuk është përkthyer i tëri në gjuhën shqipe dhe serbe, por i njëjti publikohet kryesisht vetëm në gjuhën angleze.

Gjetjet e FDHK:

Në rast se një pjesë e konsiderueshme e seancave gjyqësore janë të mbyllura për publikun, kjo ngre pikëpyetje serioze në lidhje me transparencën e gjykatës. Transparenca në sistemin gjyqësor është një element kyç për të siguruar drejtësi të barabartë dhe për të rritur besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Gjykatat zakonisht janë të hapura për publikun për të siguruar që është duke u respektuar parimi i publicitetit, përveç rasteve kur kërkohet mbyllja e seancave për arsye të veçanta. Nëse një pjesë e konsiderueshme e seancave janë të mbyllura për publikut, kjo mund të nënkuptojë një mungesë të transparencës dhe të shkaktojë shqetësime në lidhje me qasjen e publikut dhe mediave në proceset gjyqësore, duke e bërë të vështirë kontrollin publik mbi vendimet gjyqësore.


Opinionin ka të drejtë t'i dëgjojë deklaratat e dëshmitarëve, por gjithnjë gjykata duhet të kujdeset që vetëm informata të cilat ndikojnë në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur të redaktohen dhe jo e tërë dëshmia e dëshmitarit.

Me vazhdimin e kësaj praktike, transparenca e këtyre gjykimeve dhe parimi i publicitetit rrezikon të humbas kuptimin e tij.

Krahasuar me të gjitha proceset gjyqësore për krimet e luftës pranë gjykatave në Kosovë dhe pranë Tribunalit të Hagës, rastet për krimet e luftës pranë DHSK po shqyrtohen në seanca më të mbyllura.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" dhe nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".



Federal Department of Foreign Affairs FDFA

